



### Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 351/02-29366/22 dt. 10.02.2022, në emër të aplikuesit subjektit afarist “SOVEREIGN KS” sh.p.k, me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811275701, me pronar Arbër Hadri nga Peja, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kriteret e caktuara për ndërtimin, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimore - shtëpisë familjare me etazhitet B+S+P+1, në kuadër të bllokut urban “D-01”, të tërësisë urbane “D”, të Planit Rregullues të Hollësisëm “Sofalia” 2016-2024, në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. P-71914059-01213-15 ZK Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 28.04.2022 deri më 02.05.2022, në e-mail adresën: [urbanizmprištine@rks-gov.net](mailto:urbanizmprištine@rks-gov.net)

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Banim individual me etazhitet -B+S+P+1
b. Vija rregulluese (VRR)	Kufiri i parcelës kadastrale / Rruga ekzistuese 5 m’
c. Vija ndërtimore (VN) nga skaji i kufive të parcelës kadastrale nga c.1. Rruga Publike c.2. Anët – djathtas (AD) c.3. Anët – majtas (AM) c.4 Pasmë	5 m’ Kthina primare min 0.5 H Kthina sekondare min 0.2 H Më marrëveshje me fqin, deri në bashkim të plotë.
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike.	5 m’
e. Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga anësor (anësor djathtas ndërtimit AD dhe anësor majtas AM) dhe i pasmë (P) të parcelës kadastrale	AM - Kthina primare min 0.5 H AD - Kthina sekondare min 0.2 H Më marrëveshje me fqin, deri në bashkim të plotë.
f. Përqindja e sipërfaqes të përgjithshme shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës kadastrale - ISHP	ISHP = 28.24 % 30 % e lejuar sipas PRR-së
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale - ISHGJ	ISHGJ 50 % e lejuar sipas PRR-së
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale - ISPN	ISPN = 63.27 % 80 % e lejuar sipas PRR-së
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale - ISHPN	ISPN = 34.46 % 50 % e lejuar sipas PRR-së
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	1
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	Po
m. A ka qasje të pakufizuara në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
n. shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me te madhe se sa zona për rreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, si shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Nënshkrimi i Zyrtarit:

